



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE, NDJEKJES SË INVESTIMEVE DHE
INFRASTRUKTURËS

Nr.741/1Prot

Shkodër, më 30.01.2019

Lënda: Kthim Përgjigje kërkesës suaj nr. 23, datë 17.01.2019

Rruga _____

Në përgjigje të kërkesës suaj nr. 23, datë 17.01.2019, regjistruar me nr.741 prot., datë 17.01.2019 pranë Bashisë Shkodër, si dhe bazuar në Ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e Informimit”, Ju informojmë:

Gjatë ditëve 9 –22 janar 2019 Bashkia Shkodër është përballur me një situatë të vështirë të krijuar nga reshjet e dëborës.

Bashkia Shkodër, duke vlerësuar parashikimet për vështirësitë nga reshjet nga ka organizuar të gjitha kapacitetet e saja me mjete, logjistikë dhe burimet njerëzore.

Lista e plotë e kompanive të kontraktuara për mirëmbajtjen e akseve rrugore është si më poshtë.

- Subjekti “Rroku GUEST”sh.p.k., i kontraktuar për “Shërbime për mirëmbajtje emergjente të rrugëve”, me vlerë 1 200 000 lekë (me TVSH), me kapacitete prej 10 punonjësish, ndër to inxhinirë ndërtimi e hidroteknik, manovratorë dhe punëtorë, me mjetet teknike të nevojshme për realizimin e kontratës. Bashkëngjitur keni kopje të deklaratës së disponimit të makinerive të angazhuara për këtë kontratë. Ky subjekt është angazhuar për pastrimin e rrugëve nga dëborë në rrugën e Prekalit, rrugë të brendshme të Njësisë Administrative Postribë dhe Prekal Kir –Mali i Shoshit, për periudhën 9 janar 2019 e në vazhdim.

- Subjekti “Blinishta” sh.p.k., i kontraktuar për “Mirëmbajtje rruga Prekal-Kir-Mali i Shoshit-Breglumi-Nderlytaj”, me vlerë 1 784 000 lekë (me TVSH), me kapacitete prej

12 punonjësish, ndër to inxhinier ndërtimi, teknik ndërtimi, manovratorë dhe punëtorë, me mjetet teknike të nevojshme për realizimin e kontratës Bashkëngjitur keni kopje të deklaratës së disponimit të makinerive të angazhuara për këtë kontratë. Ky subjekt është angazhuar për pastrimin e rrugëve nga dëborë Prekal-Kir-Mali i Shoshit Breglumi për periudhën 14 janar 2019 e në vazhdim.

- Subjekti “Nika”sh.p.k. i kontraktuar për “Mirëmbajtje rruga Qafethore-Thethe-Nderlyasaj”, me vlerë 900 000 lekë (me TVSH), me kapacitete njerëzore prej 10 punonjësish, ndër to inxhinier ndërtimi, teknik ndërtimi, manovratorë dhe punëtorë, me mjetet teknike të nevojshme për realizimin e kontratës. Bashkëngjitur keni kopje të deklaratës së disponimit të makinerive të angazhuara për këtë kontratë. Angazhimi i subjektit për mirëmbajtjen e rrugës do të vazhdojë në momentin që kjo bëhet e mundur, pas sigurimit për vazhdimësinë për shkak të rrezikshmërisë që aktualisht ajo paraqet.

Lista e detajuar e mjeteve faktike teknike dhe njerëzore të përdorura nga vetë Bashkia Shkodër për pastrimin e dëborës, gjatë ditëve të reshjeve, është si më poshtë:

- Nga Ndërmarrja e Ujësjellës-Kanalizimeve Sh.a. janë përdorur mjetet e kapacitetet teknike të saj dy fadromat e ujësjellësit, një mjet transporti 7 tonësh, tre kamionçina transporti për shpërndarjen e kripës si dhe dy fuoristrada të njësisë së Task Forcës. Mjetet kanë punuar gjatë gjithë kohës duke bërë të mundur mbajtjen hapur për qarkullimin e mjeteve në të gjitha rrugët kryesore e dytësore të qytetit dhe Njësive Administrative të prekura nga dëborë. Nga kjo Ndërmarrje janë shfrytëzuar të gjitha kapacitetet njerëzore: 60 punonjës duke brigadën e kanalizimit të ujrave të bardha, brigadën e hidraulikëve, brigadën e kanalizimeve të ujrave të zeza, brigadën elektromekanike, të cilët janë angazhuar me mjetet dhe makineritë në dispozicion për pastrimin e borës në të gjitha akset kryesore dhe dytësore të qytetit.

Përparësi është treguar në pastrimin nga dëborë në afërsi të Institucioneve kryesore sikurse pranë: bllokut të spitaleve, ambulances së qytetit, qendrave shëndetësore, në hyrje të shkollave, pranë Universitetit, Bashkisë, Institucionit të Prefektit, Drejtorisë Vendore të Policisë, Gjykatave, Prokurorisë, etj. Punëtorët kanë bërë shpërndarjen e kripës pas fadromave. Brigadat e punës kanë punuar edhe në pastrimin e trotuareve nga dëborë në rrugët e qytetit.

- Nga Drejtoria e Shërbimit Bujqësor dhe Pyjor janë angazhuar 28 punëtorë, të cilët kanë punuar në pastrimin e trotuareve të rrugëve të qytetit nga dëborë. Është përdorur një mjet transporti, fuoristradë me karroceri për nevojat sipas situatave të paraqitura.
- Gjatë këtyre ditëve janë angazhuar edhe 25 punëtorë të Ndërmarrjes së Gjellbërimit, të cilët me mjete e vegla pune kanë bërë pastrimin e dëborës në rrugicat e trotuaret e qytetit. Gjithashtu janë përdorur edhe një mjet kamionçinë për shpërndarjen e kripës në

rrugët e qytetit si dhe një autovinç me kosh për shkundjen dhe lirim të ngarkesave të dëborës në pemët e rrugëve të qytetit.

Operatori i shërbimit të pastrimit të qytetit “Borshi”sh.p.k. ka angazhuar 25 punëtorë në dy zonat e shërbimit për pastrimin dhe lirim të trotuareve nga dëborat gjatë gjithë ditëve të situatës. Është bërë lirim nga bora dhe pastrimi i të gjitha pikave të grumbullimit të mbetjeve urbane me punonjësit e vet, duke bërë të mundur evadimin e mbetjeve urbane pa cënuar grafikun e shërbimit.

- Operatori sipërmarrës i mirëmbajtjes së varrezave publike “Bashkim Vllaznimi”sh.p.k. ka angazhuar 10 punëtorë dhe një mjet fadromë duke realizuar hapjen e rrugës kryesore dhe rrugëve të brendshme të varrezave publike duke krijuar hapësirat dhe mundësinë e realizimit të shërbimeve të varrimeve në kohë.

Janë vetëofruar në këtë situatë të vështirë të kësaj periudhe të krijuar nga dëborat disa sipërmarrës privatë të ndërtimit me kapacitete njerëzore dhe mjete të specializuara si më poshtë:

- “ALBTIEFBAU” sh.p.k. me dy mjete: një mjet borëpastruese dhe një grejder;
- “SMO Vataksi” sh.p.k. me dy mjete: një grejder dhe një borëpastruese;
- “Mantovani Beton”sh.p.k me një mjet fadromë;
- “KM Konstruksion”sh.p.k. me një mjet fadromë;
- “ALB Konstruksion”sh.p.k. me një mjet grejder;
- “Karl Gega”sh.p.k. me një mjet fadromë;
- “GYSI” sh.p.k. me një mjet fadromë;

Të gjithë këto mjete kanë punuar çdo ditë dhe janë shpërndarë sipas grafikut të punës të përcaktuar nga Bashkia Shkodër në rrugët e qytetit Shkodër si dhe në Njësitë Administrative Rrethina, Guri i Zi, Postribë e Dajç, duke iu përgjigjur në kohë situatave të krijuara.

Korespondencat, problematikat e hasura dhe masat që do merren për situatat:

Bashkia Shkodër gjatë ditëve të kësaj situatë ka mbajtur komunikim të vazhdueshëm me të gjitha institucionet lokale si pjesë e komisionit të emergjencave civile pranë Bashkisë Shkodër, me institucionet qendrore si Institucioni i Prefektit të Qarkut Shkodër, si dhe me Drejtorinë e Përgjithshme të Emergjencave Civile pranë Ministrisë së Mbrojtjes, Tiranë, duke dhënë informacion të përditshëm për situatën. Çdo ditë ky informacion është bërë publik nga Bashkia Shkodër dhe mund ta gjeni të publikuar në faqen e komunikimit Facebook “Bashkia Shkodër”.

Gjatë kësaj periudhe janë përballuar situatat e krijuara nga reshjet e dëborës.

Bashkia e Shkodrës ka realizuar pastrimin dhe mirëmbajtjen e segmentit kryesor në hyrje të qytetit, segmenti rrugor të unazës lindore dhe perëndimore të qytetit si dhe segmentin e rrugës Ura e Bunës – Shirokë, të cilat janë në administrim për mirëmbajtje nga Autoriteti Rrugor Shqiptar. Bashkia Shkodër me kapacitetet dhe mjetet e veta në dispozicion ka ndërhyrë në këto rrugë, duke i mbajtur vazhdimisht të kalueshme. Kjo ka kërkuar angazhimin e mjeteve tona në dispozicion për një kohë të gjatë për këtë qëllim, gjë e cila na ka kufizuar mundësitë për ndërhyrje në rrugët dytësore të qytetit. Megjithatë, Bashkia Shkodër ka vazhduar punën sipas këtij prioriteti: e ara duke mundësuar transportin në rrugët kombëtare, rrugët kryesore të qytetit dhe më pas në ditët në vijim ka vijuar punën për pastrimin e rrugëve dytësore në vazhdimësi.

Bashkia Shkodër në vijimsi ka kapacitetet për të angazhuar mjetet dhe subjektet, burimet njerëzore teknike dhe operative të sipërcituara. Në vitin 2019, në zbatim të Vendimit të Këshillit Bashkiak, në zbatim të buxhetit 2019, do të vijojë me prokurimin për shërbimet për mirëmbajtjen sipas planifikimit buxhetor, me blerjen e kripës si dhe me blerje për mjete të tjera në vijim të synimit, që tashmë prej tre vitesh ka nisur, për rritjen e kapaciteteve të teknike të saj.

Duke Ju falenderuar !

KRYETAR

Voltana ADEMI